



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

MODEL TESTI

PROVIMET KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË 2025

Lënda: Matematikë

Udhëzime për nxënësin:

Testi përmban gjithsej **50 pikë**.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Testi ka **25 pyetje**.

Për pyetjet me alternativa rrethoni vetëm përgjigjen e saktë, ndërsa për pyetjet me zhvillim është lënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Pyetja	1	2	3	4	5	6	7	8
Pikë								
Pyetja	9	10	11	12	13	14	15	16a
Pikë								
Pyetja	16b	17a	17b	18	19a	19b	20a	20b
Pikë								
Pyetja	21a	21b	22	23	24	25a	25b	25c
Pikë								

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

Për pyetjet 1-13 rrethoni vetëm shkronjën që i përgjigjet alternativës së saktë.

1. Jepet bashkësia $A = \{x \in N / x \text{ plotëpjesëtohet me } 3 \text{ dhe } 5\}$.

Qarkoni numrin i cili është element i bashkësisë A.

1 pikë

- A) 10
- B) 15
- C) 20
- D) 27

2. Shuma e numrave $2\frac{2}{5}$ dhe $\frac{3}{5}$ është:

1 pikë

- A) 7
- B) 5
- C) 3
- D) 2

3. Numri 1 000 000 shkruhet në trajtën 10^{2a} .

Vlera e së panjohurës "a" është:

1 pikë

- A) 10
- B) 6
- C) 3
- D) 2

4. Andi u peshua në një farmaci. Masa e tij ishte 98 kg.

Ai mbajti një regjim ushqimor, shoqëruar edhe me aktivitet fizik.

Kur ai u peshua pas një jave, masa e tij ishte 94,6 kg.

Afërsisht me sa përqind u zvogëlua masa e Andit gjatë kësaj jave?

1 pikë


- A) 3,0%
- B) 3,5%
- C) 3,6%
- D) 4,0%

5. Në tri nga kulmet e një sheshi në formë drejtkëndore, janë vendosur tri shtylla ndriçimi: A, B dhe C.

Bazuar te të dhënat në skicën e mëposhtme, sa është distanca d mes shtyllave A dhe C?

1 pikë

- A) 180 m
- B) 150 m
- C) 140 m
- D) 130 m



6. Kostoja C në euro për të prodhuar x disqe, nga një studio diskografike është modeluar sipas ekuacionit $C = 3,5x + 900$. Sa euro do t'i kushtojë studios për të prodhuar 1000 disqe?

1 pikë

- A) 3500
- B) 4500
- C) 4400
- D) 1250

7. Cili nga numrat e mëposhtëm është një zgjidhje e inekuacionit $7x + 3^2 \leq 2^4$?


1 pikë

- A) 0
- B) 2
- C) 3
- D) 4

8. Brinja e shumëkëndëshit të rregullt në figurë e ka gjatësinë $a = 0,5 \text{ dm}$.

Perimetri i tij, i shprehur në cm është:


- A) 60 cm
- B) 50 cm
- C) 40 cm
- D) 30 cm



1 pikë

9. Bazuar në të dhënat e figurës përbri, masa e panjohur e këndit x është:

- A) 50°
- B) 60°
- C) 70°
- D) 80°



1 pikë

10. Drejtëza me ekuacion $y = 2x + 6$ kalon nga pika $M(-2; y)$.


Ordinata e pikës M është:

- A) 2
- B) 1
- C) -1
- D) -2

1 pikë

11. Shndërrimi gjeometrik, i cili pasqyron trekëndëshin P në trekëndëshin Q është:

- A) zhvendosje paralele.
- B) simetri boshtore.
- C) zmadhim.
- D) rrotullim.



1 pikë

12. Dihet se $x - 1 = 1 - x$. Vlera e shprehjes x^{11} është:

1 pikë

- A) 0
B) 1
C) 2
D) 11


13. Deani kreu 8 gjuajtje radhazi me shigjetë në një tabelë shënjimi.

Më poshtë paraqiten rezultatet e gjuajtjeve të tij, sipas zonave të tabelës.

Sa është probabiliteti që në gjuajtjen e radhës, Deani të shënojë tek zona 10?

1 pikë

- A) 25%
B) 30%
C) 60%
D) 62,5%



Zona	10	9	8
Denduria	2	1	5

Pyetjet 14-25 janë me zhvillim dhe me arsyetim.

14. Benardi thjeshtoi shprehjen $\left(\frac{\sqrt{9} - \sqrt{25}}{4} + \frac{1}{8} \right) \div 1,25$

Ai i thotë shokut të tij se, vlera e thjeshtuar e shprehjes duhet të dalë 0,5.

A ka të drejtë Benardi?

PO

JO

Argumentoni përgjigjen tuaj duke kryer thjeshtimin e shprehjes më sipër.

3 pikë


15. Një nxënës ka mbajtur shënim mungesat e bëra gjatë katër muajve të parë të vitit shkollor.

Të dhënat ai i organizoi në grafikun me shtylla, i cili paraqitet më poshtë.

Mesatarisht, sa mungesa në muaj ka bërë ky nxënës gjatë kësaj periudhe?

Jepni përgjigjen tuaj në numrin e plotë më të afërt.

2 pikë



16. Një varg aritmetik e ka kufizën e parë 13 dhe rregulla kufizë pas kufize është “zbrit 2”.

a) Shkruani tri kufizat e para të këtij vargu. **2 pikë**

b) Tregoni duke argumentuar, se kufiza e tetë e këtij vargu, është kufiza e parë negative e tij. **2 pikë**

17. Flori u nis nga qyteti A për në qytetin B me makinën e tij.

Gjatë 2 orëve të para ai udhëtoi me një shpejtësi konstante $V = 80 \text{ km / orë}$.

Më pas ai pushoi për 30 minuta në një stacion dhe vazhdoi udhëtimin e tij me të njëjtën shpejtësi deri sa mbërriti në qytetin B, i cili ndodhej 36 km larg stacionit.

Duke ditur lidhjen $rruga = shpejtësi \times kohë$, gjeni:

a) distancën ndërmjet qyteteve A dhe B. **2 pikë**

b) kohën në minuta të udhëtimit të Florit, nga stacioni ku pushoi deri në qytetin B. **2 pikë**

18. Dea pa në internet recetën e një supe për 6 persona.




Disa nga përbërësit dhe sasi të përkatëse të kësaj recete janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Ajo dëshiron të përgatisë këtë supë për 4 persona.

Plotësoni tabelën me sasi të përbërësve që i duhen Deas për përgatitjen e kësaj supe.

Demonstroni veprimet tuaja matematikore.

3 pikë

Përbërësit	Karota	Patate	Brokoli
			
6 persona	90 gr	75 gr	60 gr
4 persona			

19. Jepet funksioni $f : y = 2x + 1$.


a) Gjeni $f(0)$. **1 pikë**

b) Shkruani formulën për funksionin e anasjellë të funksionit të dhënë. **2 pikë**

20. Në planin koordinativ paraqitet trekëndëshi kënddrejtë $\triangle ABC$.

a) Vizatoni pasqyrimin $\triangle ABC \rightarrow \triangle A'B'C'$ në simetrinë sipas boshtit (oy).

2 pikë



b) Shkruani koordinatat e shëmbëllimit të kulmit C në këtë shndërrim : $C'(\text{---}; \text{---})$


1 pikë

21. Në figurën e mëposhtme jepen $m(\widehat{ACB}) = m(\widehat{DEC}) = 90^\circ$ dhe $AC = 2DE$.

Pika B është mesi i segmentit EC dhe $AC = EC$.

a) Provoni se $\triangle ABC \cong \triangle CDE$.

2 pikë



b) Tregoni se $m(\widehat{AMD}) = 90^\circ$

2 pikë

22. Një banakier për 7 minuta mund të lajë 2 filxhanë dhe 3 gota.


Ky banakier për 3 minuta mund të lajë 1 filxhan dhe 1 gotë.

Gjeni kohën që i duhet këtij banakieri për të larë 10 gota.

3 pikë

23. Në planin koordinativ paraqitet drejtëza (a) dhe pikëprerjet e saj me boshtet koordinative, pikat A dhe B. Shkruani ekuacionin e drejtëzës (a).

2 pikë




24. Një nxënës ka grumbulluar 50 monedha identike.

Secila prej tyre e ka trashësinë $3,2 \text{ mm}$.

Nxënësi i vendos monedhat një mbi një, duke formuar një trup cilindrik me vëllim $36\pi \text{ cm}^3$.

Sa është diametri i një monedhe?

3 pikë



25. Më poshtë paraqitet tabela e të dhënave mbi masat (në kg) të bebeve të sapolindura gjatë një fundjave në një maternitet.

a) Cila është klasa modale?

Masa m e bebeve (kg)	Denduria
$0 < m \leq 2$	4
$2 < m \leq 3$	8
$3 < m \leq 4$	16
$4 < m \leq 5$	2

1 pikë

b) Ç 'pjesë e të porsalindurve e kanë masën jo më shumë se 3kg?

1 pikë

c) Sa është probabiliteti që një bebe e zgjedhur rastësisht, të jetë me masë mbi 4 kg?

1 pikë